



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Raport Vjetor

2013

Prishtinë
Shkurt 2014

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	3
II. PJESA E PËRGGJITHSHME	3
III.ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KËSHILLIT	4
IV.FUNKSIONET E KËSHILLIT	4
V.PROBLEMET DHE VËSHTIRËSITË.....	5
Bashkëpunimi.....	5
A. FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE.....	6
1. Ankesat e arritura sipas objektit:	6
2. Ankesat e ushtruara, sipas strukturës gjinore të ankuesve:	8
3. Ankesat e ushtruara, sipas strukturës etnike:	9
4. Ankesat e ushtruara sipas strukture Institucionale	10
ANKESAT E PARASHTRUARA NDAJ VENDIMEVE TE INSTITUCIONEVE	11
1. Institucionet e Administrates Qendrore	12
2. Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura	14
3. Institucionet e Administrates Lokale	17
NDARJA E ANKESAVE SIPAS FORMES SE VENDOSJES	19
1. Të aprovuara	19
2. Pjesërisht të aprovuara.....	19
3. Të refuzuara.....	19
4. Të hedhura poshtë.....	19
5. Të shpallura jo-kompetent	20
6. Ri shqyrtim.....	20
7. Përfundim Procedimi	20
8. Të pezulluara	20
9. Tërheqje ankesës	20
FORMAT E VENDOSJES NDAJ VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE.....	21
1. Institucionet e Administrates Qendrore	21
2. Institucionet eAdministrata Lokale	22
3. Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura	23
ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT	25
B. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES.....	27
Fushat e Mbikëqyrjes në Shërbimin Civil.....	28
C. FUNKSIONI I VËZHGIMIT.....	31
VII. RAPORTI PER SHPENZIMIN E BUXHETIT TE KËSHILLIT	34

I. HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës, i paraparë me nenin 101 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-028 për Procedurën Administrative, Rregullorja nr. 01/2011 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja nr. 02/2011 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli gjatë vitit 2013, përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil është angazhuar që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

Këshilli është organizatë e pavarur buxhetore, që financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet e ndryshme.

II. PJESA E PËRGJITHSHME

Më qëllim që Republika e Kosovës të ketë një shërbim civil efikas, të paanshëm, i bazuar në parimin e meritës dhe që pasqyron diversitetin e popullit të Kosovës, Këshilli, gjatë kryerjes së funksioneve të tij për periudhën raportuese, përmes shqyrtimit të ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për punësim në shërbimin civil, mbikëqyrjen e respektimit të ligjit dhe parimeve udhëheqëse në shërbimin civil si dhe vëzhgimin e zgjedhjes së nëpunësve të nivelit drejtues, ka konstatuar se në shërbimin civil ka një progres. Megjithatë, nga ushtrimi i funksioneve të tij, Këshilli ka vërejtur që në raste të caktuara nuk janë respektuar rregullat dhe parimet e shërbimit civil.

Disa nga nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues (Zyrtarët Kryesor Administrativ), përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit kanë treguar neglizhencë dhe papërgjegjësi në zbatimin e vendimeve të Këshillit, gjë që në pajtim me nenin 15 paragrafin 1 dhe paragrafin 5 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin, Këshilli rregullisht ka njoftuar me shkrim Kryeministrin, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe eprorët e secilit institucion që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit, edhe pse njoftimet kanë qenë raporte disiplinore sipas ligjit, nuk është ndërmarrë as edhe një rast i vetëm disiplinor. Disa nga institucionet të cilave u janë dërguar rekomandimet kanë treguar neglizhencë dhe papërgjegjësi në zbatimin e tyre, por edhe nuk e kanë njoftuar Këshillin për zbatimin ose mos zbatimin e vendimeve.

Nga mbikëqyrja e institucioneve për respektim të ligjit, është konstatuar se jo të gjitha institucionet kanë dosjet e personelit në nivelin e standardeve të kërkuara. Komisionet disiplinore dhe të ankesave, në disa raste ndikohen në vendimmarrje. Mundësitë e barabarta për punësimin në shërbimin civilë për komunitete dhe gjini nuk janë në nivelin e kënaqshëm sipas kritereve që ka përcaktuar ligji.

Sa i përket emërimit të nëpunësve të nivelit drejtues është vërejtur një përmirësim në zbatimin e rregullave dhe procedurave për rekrutimin e nivelit drejtues, si rezultat i ushtrimit të plotë të funksionit të Këshillit në vëzhgim. Në këtë pikë, Këshilli vlerëson edhe bashkëpunimin e institucioneve përkatëse.

III. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KËSHILLIT

Organizimi i brendshëm i Këshillit është i rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe me Rregulloren 02/2012 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit.

KËSHILLI përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit zgjidhen përmes konkursit të hapur dhe transparent, dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor të Kosovës. Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar me mundësi rizgjedhje. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit me mandat dy vjeçar.

Më 15 dhjetor 2013 katër prej anëtarëve të Këshillit, ju ka skaduar mandati dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës me datën 12 dhe 13 dhjetor 2013 ka zgjedhur katër anëtarë të rinj. Po ashtu, në këtë periudhë Këshilli ka zgjedhur Kryetarin e Këshillit.

SEKRETARIATI i Këshillit, ndihmon Këshillin në realizimin e funksioneve dhe detyrave, sipas Rregullores Nr.02/2012 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Këshillit dhe përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv dhe dy departamente. Aktualisht në Sekretariatit e Këshillit janë të angazhuar 18 të punësuar në cilësinë e nëpunësve civilë.

IV. FUNKSIONET E KËSHILLIT

Këshilli në pajtim me Ligjin nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ushtron tri funksionet si në vijim:

1. Funksioni i shqyrtimit të ankesave – përmes këtij funksioni Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

2. Funksioni i vëzhgimit - përmes këtij funksioni, Këshilli vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Funksioni i Mbikëqyrjes - përmes këtij funksioni Këshilli mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

V. PROBLEMET DHE VËSHTIRËSITË NË KRYERJEN E FUNKSIONEVE TË KËSHILLIT

Problemet dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar dhe vazhdon të ballafaqohet Këshilli, gjatë periudhës raportuese janë:

- Buxheti i pa mjaftueshëm në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kufizon në masë të madhe ushtrimin e funksioneve të Këshillit, me theks të veçantë ushtrimin e funksionit të monitorimit në institucionet qendrore dhe lokale si dhe përfaqësive diplomatike jashtë vendit, si dhe funksionit të vëzhgimit të procedurës së emërimit të nivelit drejtues, për shkak të mungesës të mjeteve buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të transportit;
- Mosmiratimi i kërkesës buxhetore të Këshillit për projekte kapitale;
- Mungesa e zyrave e vështirëson punën e anëtarëve të Këshillit, në shqyrtimin dhe zgjidhjen efikase të lëndëve, mbajtjen e takimeve të Këshillit dhe mbajtjen e seancave dëgjimore dhe seancave të kolegjeve për shqyrtimin e ankesave. Edhe përkundër përpjekjeve të Këshillit që përmes Ministrisë së Administratës Publike të gjindet hapësirë e mjaftueshme, kjo akoma nuk është arritur dhe si rrjedhojë e kësaj Këshilli dhe Sekretariati i Këshillit punojnë në kushte jashtë çdo standardi të përcaktuar për punë.

VI. BASHKËPUNIMI

Këshilli gjatë vitit raportues, ka zhvilluar më tej bazat e kultivimit të frymës së bashkëpunimit të mirë me institucionet dhe organizatat vendore e ndërkombëtare.

Një bashkëpunim të frytshëm Këshilli ka pasur me Misionin e OSBE në Kosovë dhe me Komisionin për Shërbimin Civil të Republikës së Shqipërisë.

FUNKSIONET E KËSHILLIT

Kapitujt në vijim paraqesin një pasqyrim të plotë të mënyrës së ushtrimit të funksioneve nga ana e Këshillit si dhe aktivitetet e kryera nga Këshilli gjatë periudhës një (1) vjeçare të raportimit, **1 Janar - 31 Dhjetor 2013**.

A. FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Gjatë vitit 2013 në Këshill, kanë arritur gjithsej **452** ankesa, të parashtruara nga nëpunësit civilë dhe kandidatët për punësim në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në mënyrë që të specifikohen më saktësisht natyra e ankesave, Këshilli në këtë raport ka ndarë ankesat sipas:

1. objektit;
2. strukturës gjinore;
3. strukturës etnike dhe
4. strukturës institucionale.

1. Ankesat e arritura sipas objektit

Baza e ankimit të nëpunësve civilë që ankohen në Këshill, është e ndryshme. Gjatë vitit 2013 shumica e ankesave, kanë pasur për objekt kompensimin e pagave dhe shtesave, kontestim konkursi, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, masa disiplinore, ndërrimi i vendit të punës, transferim, mosvazhdimi i kontratës së punës, suspendim, vlerësimi i rezultateve në punë, ulje në pozitë, ngritje e koeficientit, e të tjera. Shih Tabelën e mëposhtme:

	Objekti i ankesave	Numri	Përqindja
1	Kompensimi i pagave dhe shtesave	140	30.39%
2	Kontestim konkursi	105	23.23%
3	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	50	11.06%
4	Degradim	23	5.08%
5	Masa disiplinore	19	4.20%
6	Transferim	17	3.76%
7	Mosvazhdimi i Kontratës së punës	16	3.53%
8	Ngritje e koeficientit	14	3.09%
9	Suspendim	10	2.21%
10	Pezullim nga puna	9	1.99%
11	Nivelizimi i pagave	7	1.54%
12	Moslëshimi i aktemërimit	6	1.32%
13	Vlerësimi joobjektiv	5	1.10%
14	Sistemimi në vend pune	4	0.88%
15	Kundër shpalljes së konkursit	4	0.88%
16	Kundër anulimit të konkursit	4	0.88%
17	Lejimi i veturës zyrtare	3	0.66%
18	Ulje e koeficientit	2	0.44%

19	Kundër kontratës tremujore	1	0.22%
20	Kundër vendimit të Kom. disiplinor	1	0.22%
21	Kontestim i vendimit të A.P.	1	0.22%
22	Kundër Aktemërimit	1	0.22%
23	Kthimi në vendin e punës	1	0.22%
24	Kundër kontratës	1	0.22%
25	Kundër pezullimit të ankesës	1	0.22%.
26	Kundër caktimit në Ushtrues Detyre	1	0.22%
27	Mosavansim	1	0.22%
28	Mosekzekutimi i aktpajtit	1	0.22%
29	Mosekzekutimi i Vendimit të Komisionit të Ankesave	1	0.22%.
30	Ndërrimi i titullit të punës	1	0.22%
31	Ndërrimi i vendit të punës	1	0.22%.
32	Precizimi i Vendimit	1	0.22%
	Totali	452	100%

Tabela 1. Tregon përqindjen e ankesave të arritura, sipas objektit.




Fig nr.1 Ankesat e arritura sipas objektit




Fig nr. 2 Ankesat e arritura sipas objektit

2. Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve

Nga numri i përgjithshëm i ankesave prej 452 të arritura në vitin 2013, ndarja sipas gjinisë është si në vijim: meshkuj 362 ose 80.08%, ndërsa femra 88 ose 19.94%.

Nga numri i përgjithshëm prej 452 ankesave, 1 ankesë është parashtruar nga grup ankuesish dhe 1 ankesë nga Institucioni.

Nr. Rendor	Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore	Numri	Përqindja
1	Meshkuj	362	80.08%
2	Femra	88	19.94%

3. Tabela nr.2 Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve




Fig 3. Tregon përqindjen e ankuesve sipas strukturës gjinore

3. Ankesat e ushtruara, sipas strukturës etnike

Struktura etnike e ankuesve që i janë drejtuar Këshillit është: Shqiptarë 439 ose 97.12%, Serb 8 - 1.76%, Boshnjak 3 ose 0.66% dhe Turq 2 ose 0.44% %; Shih tabelën dhe diagramin.

Nr. Rendor	Ankesat e ushtruara sipas strukturës etnike	Numri	Përqindja
1	Shqiptar	439	97.12%
2	Serb	8	1.76%
3	Boshnjak	3	0.66%
4	Turq	2	0.44%

Tabela nr. 3 Ankesat sipas strukturës etnike




Fig 4. Tregon përqindjen e ankuesve sipas përkatësisë etnike

4. Ankesat e parashtruara sipas strukturës institucionale

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa nga nëpunësit civil dhe kandidatët për punësim të parashtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit, si në vijim: Institucionet e Administratës Qendrore janë 150 ankesa ose 33.18 %, Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura janë 149 ose 32.96% dhe nga Administrata lokale 153 ankesa ose 33.84 %. Shih tabelën në vijim:

Nr.	Ankesat e ushtruara kundër organeve punëdhënëse	Numri	Përqindja
1	Institucionet e Administratës Qendrore	150	33.18%
2	Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura	149	32.96%
3	Administrata lokale	153	33.84%

5. Tabela nr. 4 Ankesat e parashtruara sipas strukturës institucionale




Fig. 5 Tregon përqindjen e ankesave të arritura ndaj vendimeve të autoriteteve punëdhënëse

ANKESAT E PARASHTRUARA NDAJ VENDIMEVE TE INSTITUCIONEVE

Ankesat e paraqitura në Këshill, ndaj Vendimeve sipas nivelit institucional, ndahen në ankesat ndaj Vendimeve të:

1. Institucioneve të Administratës Qendrore;
2. Agjencive, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura dhe
3. Institucioneve të Administratës lokale.

1. Institucionet e Administratës Qendrore

Nëpunësit civil dhe kandidatët për punësim gjatë vitit 2013 kanë parashtruar 150 ankesa kundër vendimeve të Institucioneve të Administratës Qendrore. (Shih tabelën e më poshtme).

Nr.	Institucionet e Administratës Qendrore	Nr. I ankesave	Përqindja
1	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	30	6.63%
2	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	22	4.86%
3	Ministria e Punëve të Brendshme	16	3.53%
4	Ministria e Drejtësisë	14	3.09%
5	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	11	2.43%
6	Ministria e Punëve të Jashtme	11	2.43%
7	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	10	2.21%
8	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	7	1.54%
9	Ministria e Infrastrukturës	5	1.10%
10	Ministria e Shëndetësisë	5	1.10%
11	Ministria e Administratës Publike	4	0.88%
12	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	4	0.88%
13	Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës	3	0.66%
14	Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal	2	0.44%
15	Ministria e Integriteteve Evropiane	2	0.44%
16	Administrata e Kuvendit të Kosovës	1	0.22%
17	Ministria e Financave	1	0.22%
18	Ministria e Komuniteteve dhe Kthim	1	0.22%
19	Administrata e Presidencës	1	0.22%
20	Totali	150	33.18%

Tabela nr. 6 Tregon përqindjen e ankesave ndaj vendimeve të Institucioneve të Administratës Qendrore

Ankesat kundër Institucioneve të Administratës Qendrore sipas objektit të ankesës	Ndërpreje e mardhënies së punës	Mosvazhdim i punësimit	Kontestim konkursi	Kompenim.material	Ujje në pozitë	Suspendim	Masa disiplinore	Ndërrimi i vendit të punës	Ngritje e koeficientit	Transferim	Kthimi në vendin e punës	Vlerësimi i punës	Avancim	Të tjera	Gjithsejtë
Min. e Tregtisë dhe Industrisë	7		4		2	2	2			2		1		2	22
Min. E Infrastrukturës	3									1				1	5
M. e Drejtësisë			2	3	1				4	1				3	14
Administrata e Kuvendit				1											1
Min. e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1	1	4	3	1					1					11
Min. e Punëve të Jashtme			3		3		1			2		1		1	11
Min. e Punëve të Brendshme	1		3	3	1	1			1	3		1		2	16
Min. e Kulturës, Rinisë e Sportit	1		1	1	3									4	10
Min. e Shëndetësisë		2	1	2											5
Min. e Financave				1											1
Min. e Admin. të Pushtetit Lokal														2	2
Min. për Komunitete dhe Kthim						1									1
Min. e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë			2	3	2										7
Min. e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2		3	21		2	2								30
Min. E Administratës Publike			1	3											4
Min. e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural	2		2												4
Min. E Intergjimeve Evropiane			2												2
Min. E Forcës dhe Sigurisë së Kosovës			3												3
Zyra e Presidentit				1											1
Gjithsejtë	17	3	31	42	13	6	5		5	10		3		15	150

Tabela. 7 Tregon numrin e ankesave të ushtruara sipas objektit të ankesës ndaj Institucioneve të Administratës Qendrore

2. Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura

Nëpunësit civil dhe kandidatët për punësim gjatë vitit 2013 kanë parashtruar 149 ankesa kundër vendimeve të Agjencive, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura. (shih tabelat e mëposhtme):

Nr.	Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura	Nr. i ankesave	Përqindja
1	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	17	3.76%
2	Agjencioni i Statistikave të Kosovës	11	2.43%
3	Agjencia e Kosovës për Privatizim	11	2.43%
4	Agjencioni Kosovar i Pronës	9	1.99%
5	Prokuroria e Shtetit	9	1.99%
6	Universiteti i Pejës	7	1.54%
7	Komisioni Qendror Zgjedhor	6	1.32%
8	Agjencioni Kundërkorrupsionit	5	1.10%
9	Institucioni i Avokatit Popullit	5	1.10%
10	Spitali Rajonal -Ferizaj	5	1.10%
11	Komisioni për Ndihmë Juridike	5	1.10%
12	Agjencioni Pyjor i Kosovës	4	0.88%
13	Agjencioni Kadastral	4	0.88%
14	Inspektorati Policor i Kosovës	4	0.88%
15	Administrata Tatimore e Kosovës	3	0.66%
16	Shërbimi Korrektues	3	0.66%
17	Policia e Kosovës-Administrata	3	0.66%
18	Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale	3	0.66%
19	Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)	3	0.66%
20	Agjensioni shtetëror i arkivave të Kosovës,	3	0.66%
21	Komisioni i Pavaruar për Minerë dhe Minerale	3	0.66%
22	Universiteti i Prishtinës	2	0.44%
23	Qendra e Paraburgimit -Prishtinë	2	0.44%
24	Doganat e Kosovës	2	0.44%
25	Gjykata Kushtetuese	2	0.44%
26	Spitali Rajonal Mitrovicë	2	0.44%
27	Organi i Shqyrtimit të Prokurimit	2	0.44%
28	Agjencioni Ushqimit dhe Veterinarisë	1	0.22%
29	Njësia e Inteligjencës Financiare	1	0.22%
30	Spitali Rajonal- Gjilan	1	0.22%
31	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	1	0.22%
32	Komisioni Pavarur për Media	1	0.22%
33	Agjencioni i Aviacionit Civil të Kosovës	1	0.22%
34	Instituti Albanologjik i Kosovës	1	0.22%

35	Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik	1	0.22%
36	Spitali Rajonal Gjakovë	1	0.22%
37	Autoriteti Rregullativ i Komunik. Elektr. dhe Postar	1	0.22%
38	Gjykata Komunale –Prishtinë (Adminstrata)	1	0.22%
39	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	1	0.22%
40	Universiteti i Gjilanit	1	0.22%
41	FINCA (OJQ)	1	0.22%
	Gjithsejtë	149	32.84%

Tabela. 8 Pasqyron te dhënat mbi numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill gjatë vitit 2013 kundër Agjencive, Institucioneve dhe Organeve te Pavarura.

Ankesat e arritura kundër Agjencive, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura sipas objektit	marrëdhënse punës	Mos vazhdim i punësimit	Kontestim konkursi	Kompensim material	Ujje në pozitë	Vlerësim i punës	Masa disiplinore	Ndërrimi i vendit të punës	Transferim	Suspendim	Rritje e koef.	Të tjera	Gjithsejtë
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1	4	7	3					2				17
Agjencioni Pyjor i Kosovës	1						1		2				4
Policia e Kosovës -Administrata				1					1	1			3
Administrata Tatimore e Kosovës				1	2								3
Agjencia Kosovare e Privatizimit			2	2								7	11
Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK	1				1					1			3
Universiteti i Prishtinës -Administrata								1	1				2
Institucioni i Avokatit të Popullit	1						3			1			5
Prokuroria e Shtetit -Administrata			3	6									9
Agjencioni Kosovës për Produkte Medicinale	1		1	1									3
Agjencioni i Statistikave të Kosovës	1	2	1	2				4	1				11
Agjencioni Kadastral i Kosovës	1	2	1										4
Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik				1									1
Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë	1												1
Dogana e Kosovës- -Administrata			2										2
Spitali Rajonal -Ferizaj	1					3						1	5
Universiteti i Pejës			7										7
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm			1										1
Komisioni Pavarur për Miniera dhe Minerale				2			1						3
Gjykata Komunale Prishtinë				1									1
Agjencioni Shtetëror i Arhivave të Kosovës	1									1		1	3
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës										1			1
Agjencioni Kundërkorrupsionit			5										5
Inspektorati Policor -Administrata	2		1	1									4
Komisioni për Ndihmë Juridike			4									1	5
Komisioni Pavarur për Media			1										1
Gjykata Kushtetuese	2												2
Komisioni i Inteligjencës Financiare		1											1
Qendra e Paraburgimit Prishtinë											2		2
Spitali Rajonal Mitrovicë					1		1						2
Instituti Albanologjik				1									1
Spitali Rajonal Gjilan												1	1
FINCA (OJQ)	1												1
Agjencioni Kosovar i Pronës	6		1	1			1						9
Komisioni Qendror Zgjedhor			3	3									6
Organi i Shqyrtimit të Prokurimit	1	1											2
Shërbimi Korrektues			2									1	3
Spitali Rajonal Gjakovë			1										1
Autoriteti Rregullativ i Komunik Elektr dhe Postare												1	1
Universiteti i Gjilanit			1										1
Agjencioni i Aviacionit Civil të Kosovës			1										1
Gjithsejtë	22	10	44	26	4	3	7	5	7	5	2	13	149

Tabela nr. 9 Pasqyron numrin e ankesave të ushtruara, sipas objektit të ankesës kundër Agjencive, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura

3. Institucionet e Administratës Lokale

Nëpunësit civil dhe kandidatët për punësim gjatë vitit 2013 kanë parashtruar 153 ankesa kundër vendimeve të Institucioneve të Administratës Lokale. (Shih tabelat e më poshtme).

Nr.	Administrata lokale (komunat)	Nr. i ankesave	Përqindja
1.	Komuna Vushtrri	32	7.07%
2	Komuna Viti	19	4.20%
3	Komuna Ferizaj	17	3.76%
4	Komuna Lipjan	12	2.65%
5	Komuna Prishtinë	10	2.21%
6	Komuna Prizren	10	2.21%
7	Komuna Gjakovë	8	1.76%
8	Komuna Kamenicë	7	1.54%
9	Komuna Mitrovicë	6	1.32%
10	Komuna Gjilan	4	0.88%
11	Komuna Malishevë	4	0.88%
12	Komuna Kaçanik	4	0.88%
13	Komuna Podujevë	3	0.66%
14	Komuna Obiliq	3	0.66%
15	Komuna Rahovec	2	0.44%
16	Komuna Klinë	2	0.44%
17	Komuna Ranillug	2	0.44%
18	Komuna Graçanicë	1	0.22%
19	Komuna Deçan	1	0.22%
20	Komuna Mamushë	1	0.22%
21	Komuna Junik	1	0.22%
22	Komuna Dragash	1	0.22%
23	Komuna Pejë	1	0.22%
24	Komuna Shtërpçë	1	0.22%
25	Komuna Skenderaj	1	0.22%
	Gjithsejtë	153	33.84%

Tabela 10. Pasqyron të dhënat mbi numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill gjatë vitit 2013, sipas Institucioneve të Administratës Lokale.

Ankesat e arritura kundër Administratës Lokale (Komunave)	Ndërprerje e marrëdhënies	Mosvazhdim i punësimit	Kontestim konkursi	Kompensim material	Ulje në pozitë	Rritje koeficientit	Masa disiplinore	Vlerësim i punës	Te tjera	Gjithsejtë
Komuna e Skenderajt				1						1
Komuna e Lipjanit	1		4	5		1			1	12
Komuna e Gjilanit	1				1		1	1		4
Komuna e Podujevës	2		1							3
Komuna e Vitisë			8	2	1	1	3	1	3	19
Komuna e Prishtinës	1		4	2			2		1	10
Komuna e Kamenicës	1		1	4		1				7
Komuna e Prizrenit		1	5	2			2			10
Komuna e Obiliqit			1				1		1	3
Komuna e Vushtrrisë				31	1					32
Komuna e Klinës						2				2
Komuna e Pejës							1			1
Komuna e Shtërpcës									1	1
Komuna e Dragashit			1							1
Komuna e Mitrovicës	2			2		1			1	6
Komuna e Graçanicës		1								1
Komuna e Gjakovës	1			7						8
Komuna e Mamushës		1								1
Komuna e Deçanit			1							1
Komuna e Ranillugut				2						2
Komuna e Junikut	1									1
Komuna e Ferizajit	2		5	9			1			17
Komuna e Malishevës	3		1							4
Komuna e Rahovecit			1		1					2
Komuna e Kaçanikut			3	1						4
Gjithsejt	15	3	36	68	4	6	11	2	8	153

Tabela 11. Pasqyron ankesat sipas objektit, nga nëpunësitë civilë dhe kandidatët për punësim, kundër Institucioneve të Administratës Lokale

NDARJA E ANKESAVE SIPAS FORMËS SË VENDOSJES

Këshilli, gjatë vitit **2013** ka pranuar gjithsej **452** ankesa, ndërsa ka shqyrtuar dhe vendosur për 440 ankesa, si në vijim:

- **28 ankesa** të bartura nga viti 2012 dhe
- **412 ankesa** të arritura në vitin 2013.

40 ankesa të pranuar në fund të Dhjetorit të vitit 2013, për shkak të afatit, janë bartur për shqyrtim dhe vendosje në vitin 2014.

Kolegjet e Këshillit, në pajtim me bazën ligjore kanë shqyrtuar dhe vendosur ankesat në seanca publike-dëgjimore dhe në seanca jo publike.

MËNYRAT E VENDOSJES SË ANKESAVE

Gjatë vendosjes për një ankesë, Këshilli varësisht nga objekti i ankesës, vendos në mënyra të ndryshme. Më poshtë gjeni mënyrat e vendosjes/zgjedhjes në ankesa:

1. Të aprovuara

Janë ankesat e paraqitura nga nëpunësit civilë apo kandidatët për punësim, në shërbimin civil, që në bazë të provave dhe fakteve, Kolegjet e Këshillit i kanë aprovuar duke anuluar vendimet e organeve të punësimit dhe duke i obliguar organet e punësimit për zbatimin e tyre në afatin e përcaktuar ligjor. Numri i ankesave të aprovuara gjatë periudhës raportuese është **149**.

2. Të refuzuara

Janë ankesat e paraqitura nga nëpunësit civilë të cilat në bazë të provave dhe fakteve të paraqitura nga ankuesi dhe organi i punësimit refuzohen si të pa bazuara. Numri i ankesave të refuzuara gjatë periudhës raportuese është **170**.

3. Pjesërisht të aprovuara

Janë ankesat të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe kur ankesa nuk aprovohet në tërësi. Kjo ndodh në rastet kur organi i punësimit obligohet që të përmbush ndonjërin nga pretendimet e aprovuara ankimore. Numri i ankesave pjesërisht të aprovuara gjatë periudhës raportuese është **10**.

4. Të hedhura poshtë

Janë ankesat të cilat pranohen dhe procedohen nga ana e Kolegjeve të Këshillit, por që hedhen poshtë kur nuk është respektuar afati ligjor apo edhe mos plotësimi të ankesës në afatin ligjor nga ankuesi. Numri i ankesave të hedhura poshtë gjatë periudhës raportuese është **35**.

5. Të pezulluara

Janë ankesat e nëpunësve civil që për marrjen e vendimit përfundimtar në procedurë administrative duhet të pritët një vendim paraprak i një organi tjetër kompetent apo vendim i gjykatës. Numri i ankesave të pezulluara gjatë periudhës raportuese është **12**.

6. Kthimi në rishqyrtim

Janë vendime të cilat, Këshilli i obligon organet e punësimit brenda afatit ligjor për të ndërmarr veprimet procedurale duke nxjerr vendim ose duke i obliguar organet e punësimit për rishqyrtim të vendimeve të tyre. Numri i këtyre ankesave të vendosura në rishqyrtim gjatë periudhës raportuese është **29**.

7. Të shpallura jo-kompetent

Janë ankesat të cilat gjatë shqyrtimit të tyre nga Kolegjet e Këshillit konstatohet se për ankesat e cekura nuk është në kompetencë të Këshillit për të vendosur lidhur me objektin e këtyre ankesave, dhe në rastet e tilla veprohet sipas Ligjit të Procedurës Administrative. Lidhur me ankesat e tilla, Këshilli ka konstatuar jo kompetencën e vet për **22 ankesa**.

8. Përfundim procedimi

Janë vendime kur nëpunësit civilë, apo kandidatët për shërbim civil tërheqin ankesat, eliminohet arsyeja për ankimin për shkak të braktisjes së ankesës nga ana e ankuesit, kur pala nuk ka qenë e interesuar dhe jo aktive mbi tre muaj dhe kur konstatohet se objekti për të cilin është filluar procedimi ka humbur efektin dhe qëllimin. Numri i ankesave me përfundim procedimi gjatë periudhës raportuese është **11**.

9. Tërheqje ankesës

Janë ankesat me të cilën ankuesi, vullnetarisht me shkrim, heq dorë nga shqyrtimi i ankesës. Numri i tyre është **2**.

FORMAT E VENDOSJES NDAJ VENDIMEVE TE INSTITUCIONEVE

1. Institucionet e Administratës Qendrore

Këshilli ka vendosur **146** ankesa kundër vendimeve të organeve të punësimit të Institucionet e Administratës Qendrore, prej tyre **135** ankesa të vitit 2013 dhe **11** ankesa të vitit **2012**.

Institucionet e Administratës Qendrore (Ministritë)	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të pezulluara	Rishqyrtim	Jo kompetencë	Përfundim procedimi	Tërheqje të ankesës	Nr. ankesave të Shqyrtuara
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	8	10		2	2	3				25
Ministria e Drejtësisë		9				1	4			14
Ministria e Shëndetësisë	2			2		1				5
Ministria e Infrastrukturës	4			2						6
Ministria e Punëve të Jashtme	2	3				1				6
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	2	6		1		1	1			11
Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës		1						1		2
Ministria e Punëve të Brendshme	5	3			2	2		3		15
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	4	2	1		1	2		1		11
Ministria e Administratës Publike		1		1		1				3
Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal		2								2
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	3	2								5
Ministria e Financave	1	1		1						3
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor	3	25				1	1			30
Administrata e Presidencës								1		1
Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillit Rural	2	2								4
Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës						1				1
Ministria e Integritetit Evropian		1								1
Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit		1								1
GJITHSEJTË	36	69	1	9	5	14	6	5	-	146

Tabela 12. Tregon ankesat e shqyrtuara të vitit 2013 ndaj Institucioneve të Administratës Qendrore

2. Institucionet e Administratës Lokale

Këshilli ka vendosur **152** ankesa kundër vendimeve të Institucioneve Administrative lokale (**komunat**), prej tyre **147** ankesa të vitit 2013 dhe **5** ankesa të vitit 2012.

Administrata lokale (Komunat)	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të pezulluara	Rishqyrtim	Jo kompetencë	Përfundim procedimi	Tërheqje të ankesës	Nr. ankesave të shqyrtuara
Komuna e Skenderajt		1								1
Komuna e Lipjanit	5	5		1				1		12
Komuna e Gjilanit	3	1	1	1						6
Komuna e Podujevës	3				1					4
Komuna e Vitisë	5	10		3		1				19
Komuna e Prishtinës	4	4		1						9
Komuna e Kamenicës	1	1		2			2			6
Komuna e Rahovecit	1	1								2
Komuna e Obiliqit	1	1		1						3
Komuna e Gjakovës	6	2								8
Komuna e Vushtrrisë	20	1	3	5		1				30
Komuna e Mitrovicës	2	3				1				6
Komuna e Klinës		1		1		1				3
Komuna e Ferizajit	7	3				2	5			17
Komuna e Graçanicës	1									1
Komuna e Deçanit				1						1
Komuna e Mamushës	1									1
Komuna e Prizrenit	3	4		1			1			9
Komuna e Malishevës	3		1							4
Komuna e Junikut		1								1
Komuna e Ranillugut							2			2
Komuna e Kaçanikut	3							1		4
Komuna e Dragashit	1									1
Komuna e Pejës		1								1
Komuna e Shtërpces		1								1
Gjithsejtë	70	39	5	19	1	6	10	2	-	152

Tabela 13. Tregon ankesat e shqyrtuara të vitit 2013 ndaj Institucioneve të Administratës Lokale.

3. Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura

Këshilli ka vendosur **142** ankesa të ushtruara kundër vendimeve të Agjensioneve, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura, prej tyre **130** ankesa të vitit **2013**, ndërsa 12 ankesa të bartura nga viti **2012**.

<u>Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura</u>	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura nënshtrë	Të pezulluara	Rishqyrtim	Jo kompetencë	Përfundim procedimi	Tërheqje të ankesës	Nr. ankesave të shqyrtuara
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	7	6	2	1						16
Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK	2						2			4
Agjencioni Pyjor i Kosovës	1	2			2					5
Administrata Tatimore e Kosovës	3									3
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë		1								1
Policia e Kosovës	1				2					3
Agjencioni Kosovar i Privatizimit	3	7				1				11
Agjencia Kadastrale e Kosovës		2				1	1			4
Institucioni i Avokatit të Popullit	1	3	1			1				6
Agjencia Kundër Korrupsionit		5								5
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		1		1		1		1	1	5
Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale	2	1								3
Prokuroria Shtetit-Administrata		7				1		1		9
Agjencia e Statistikave të Kosovës	4	3							1	8
Doganat e Kosovës-Administrata		2					1			3
Spitali Rajonal në Ferizaj	4					1				5
Njësia e Intelegjencës Financiare	1									1
Universiteti i Prishtinës	2	1			1					4
Inspektorati Policor						2	1			3
Spitali Rajonal Mitrovicë	1									1
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm		1								1
Agjenciteti Rregullativ i Komunikimeve elektronike dhe postare		1								1
Instituti Albanologjik	1									1
FINCA							1			1
Spitali Rajonal Gjilan	1					1				2
Komisioni për Ndihmë Juridike		3	1	1						5

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik		1								1
Universiteti i Pejës	3	2		2						7
Komisioni i Pavarur për Media		1								1
Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës		1			1					2
Agjencioni i Aviacionit Civil të Kosovës	1	1								2
Organi i Shqyrtimit të Prokurimit	1	1								2
Shërbimi Korrektues	2			1				1		4
Spitali Rajonal Gjakovë	1									1
Gjykata Komunale Prishtinë		1								1
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	1									1
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale		1		1						2
Gjykata Kushtetuese		2								2
Agjencioni Kosovar i Pronës		2								2
Qendra e Studentëve		1								1
Qendra e paraburgimit Prishtinë		2								2
Gjithsejtë	43	62	4	7	6	9	6	3	2	142

Tabela 14. Tregon ankesat e shqyrtuara të vitit 2013 ndaj Agjencive, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura

Nga të dhënat e mësipërme lidhur me shqyrtimin dhe zgjedhjen e 440 ankesave nga Këshilli, mënyra e vendosjes së këtyre ankesave është si në tabelën në vijim:

Mënyra e vendosjes	Numri	Përqindja
Të refuzuara	170	38.63%
Të aprovuara	149	33.86%
Rishqyrtim Ex-officio	29	6.59%
Të hedhura poshtë	35	7.95%
Shpallja jo kompetent	22	5.00%
Të aprovuara pjesërisht	10	2.27%
Të pezulluara	12	2.72%
Përfundim procedimi	11	2.50%
Tërheqje ankese	2	0.45%
Gjithsejtë	440	99.97%

Tabela. 15 Tregon mënyrën e vendosjes së ankesave, numrin dhe përqindjen e tyre

ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT

Vendimet e Këshillit janë të obligueshme që të zbatohen nga organet e punësimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin. Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe duhet të ekzekutohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Mosekzekutimi i tyre nga personat përgjegjës konsiderohet cenim i të drejtave nga marrëdhënia e punës të nëpunësit në shërbimin civil dhe paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës të parapara në Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës.

Organet e punësimit kanë pasur obligim ligjor për t'i zbatuar **188** vendime të aprovuara nga Këshilli, prej tyre **149** Vendime me të cilat ankesat janë aprovuar plotësisht, **10** vendime me të cilat ankesat janë aprovuar pjesërisht, si dhe **29** vendime me të cilat janë obliguar organet e punësimit, që lëndët t'i kthejnë në rishqyrtim.

Përkundër këtij fakti që vendimet e Këshillit janë të formës së prerë në procedurë administrative, nga të dhënat rezulton se nga **188** vendimeve për zbatim, organet e punësimit, plotësisht kanë zbatuar **142** vendime, pjesërisht kanë zbatuar **1** vendim, ndërsa nuk kanë zbatuar **27** vendime të Këshillit. Këshilli për **18** vendime nuk ka informata zyrtare nga organet e punësimit se a janë ekzekutuar ose jo.

Në pajtim me nenin 15 paragrafin 2, 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas kalimit të afatit për ekzekutim të vendimit në afatin e përcaktuar ligjor, Këshilli ka dërguar **37 njoftime për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Kryeministrin dhe Eprorin e drejtpërdrejtë** të personit përgjegjës për ekzekutimin e vendimit.

Këshilli ka konstatuar se mos ekzekutimi i vendimeve në afatin ligjor, nga organet e punësimit, ka për pasojë dëmtimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës, që vjen deri tek dyfishimi i kompensimit për punëtorët që janë punësuar ende pa i përfunduar procedurat ankimore me vendim përfundimtar deri në ekzekutim. Edhe përkundër kësaj, asnjë nëpunës i nivelit të lartë drejtues nuk i është nënshtruar përgjegjësisë disiplinore, siç parashihet me nenin 15 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sipas Gjykatës Kushtetuese moszbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet kompetente, është shkelje e nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenit 6 dhe 13 të Konventës Evropiane.

Nga tabela e mëposhtme shihet se janë të ekzekutuara **142** vendime, apo **75.53%**, pjesërisht të ekzekutuara **1** ose **0.53%**, ndërsa nuk janë ekzekutuar **27**

vendime, apo **14.36 %**, ndërsa Këshilli për **18** vendime ose **9.57%** nuk ka informata se a janë ekzekutuar apo jo nga ana e organeve të punësimit.

Tabelë mbi ekzekutimin e vendimeve të Keshillit	Të ekzekutuara	Vendimet e ekzekutuara pjesërisht	Vendimet e pa ekzekutuara	S'ka informata se janë ekzekutuar apo jo
Të aprovuara	117	1	18	13
Pjesërisht të aprovuara	9		1	
Rishqyrtim	16		8	5
Gjithësejt	142	1	27	18

Tabela nr. 16

Tabela e mëposhtme tregon vendimet e ekzekutuara, pjesërisht të ekzekutuara, të pa ekzekutuara dhe ato që nuk ka informacione mbi ekzekutimin e tyre sipas Institucioneve për vitin 2013.

Ministritë	Nr. I vendimeve të pa ekzekutuara	Vendimet që nuk ka informacione
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	1	
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2	1
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1	1
Ministria e Punëve të Jashtme	1	1
Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural	1	1
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	1	
Ministria e Shëndetësisë	2	
Ministria e Infrastrukturës	1	
Gjithsejt	10	4
Komunat	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara	Vendimet që nuk ka informacione
Komuna e Podujevës	1	2
Komuna e Gjilanit	1	
Komuna e Klinës	1	
Komuna e Malishevës	1	1
Komuna e Ferizajit	1	1

Komuna e Lipjanit	1	
Komuna e Prizrenit	1	
Komuna e Vitisë	1	2
Komuna e Kamenicës	1	1
Komuna e Kaçanikut	1	1
Komuna e Dragashit	1	
Komuna e Vushtrrisë		2
	11	10
Agjencionet dhe organet e Pavaruara	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara	Vendimet që nuk ka informacione
Administrata Tatimore e Kosovës	1	1
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1	1
Spitali Rajonal Ferizaj	1	
Agjensioni i Statistikave të Kosovës	1	1
Agjencioni Kosovar i Privatizimit	1	1
Spitali Rajonal Gjilan	1	
Gjithësjt	6	4

Tabela nr. 17 Numri i vendimeve të ekzekutuara, pjesërisht të ekzekutuara, të pa ekzekutuara dhe pa informacion për ekzekutimin e tyre.

B. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES

Vlerësimi i respektimit të ligjit

Këshilli ka ushtruar funksionin e mbikëqyrjes në bazë të nenit 10 paragrafit 3 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L 192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke mbikëqyrur zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të akteve nënligjore, të cilat rregullojnë çështjet e menaxhimit, organizimin e përgjithshëm të një shërbimi civil të paanshëm politikisht, kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjelljen personale, avancimin në karrierë, si dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civil, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

Këshilli për vitin 2013, për shkak të pamundësive buxhetore për të inspektuar të gjitha Institucionet, është detyruar që të hartojë një "Plan" të kombinuar të monitorimit për organet e punësimit në nivel qendror dhe lokal përmes vizitave dhe pyetësorëve.

Në bazë të këtij plani, Këshilli ka realizuar 26 vizita **monitoruese** dhe ka dërguar pyetësor në 86 institucione qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës. Në pyetësorët e dërguar, të përgaditur në pajtim me rregullat dhe procedurat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, janë përgjigjur 45 Institucione ndërsa 41 institucione nuk janë përgjigjur fare.

Këshilli, gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në vitin 2013 ka rekomanduar Institucionet që t'i zbatojnë rekomandimet për përmirësimin e punës së njësisë së personelit, duke shqyrtuar dosjet e personelit si dhe i është kërkuar Institucioneve që të evidentoheshin problemet me të cilat ata ndeshen në praktikën e punës së përditshme të tyre.

FUSHAT E MBIKËQYRJES NË SHËRBIMIN CIVIL

1. Njësitë e personelit

Shumica e institucioneve, si qendrore ashtu edhe ato lokale, janë në përmirësim të zbatimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil, mirëpo vlen të theksohet se Menaxherët apo Udhëheqësit e personelit ende nuk e kanë rolin, përgjegjësinë dhe autorizimet që i takojnë me ligj, andaj Këshilli ka rekomanduar Zyrtarët Kryesor Administrativ që menaxherëve të personelit t'ju njihet pavarësia profesionale.

2. Pranimi në shërbimin civil

Gjatë vizitave që anëtarët e Këshillit kanë zhvilluar nëpër Institucione të ndryshme, është konstatuar se ka përmirësime të dukshme mbi bazën e respektimit të procedurave të rekrutimit, gjegjësisht nenin 18 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 10 paragrafin 1.2 dhe nenin 16 paragrafin 1.1 të Ligjit nr. 03/L192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli ka konstatuar se disa Institucione, kanë vende të lira të punës dhe nuk procedojnë me rekrutimin në pajtim me ligjin, por i mbajnë me ushtrues detyre duke tejkaluar afatet ligjore për ushtrues detyre.

Rekrutimi i disa pozitive në shërbimin civil nuk bëhet në pajtim me përshkrimin e detyrave të punës dhe kualifikimit profesional të kërkuar, siç është përcaktuar me Rregulloren 05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës lidhur me përgatitjen profesionale dhe përvojën e nevojshme.

3. Pranimi në shërbimin civil të personave më aftësi të kufizuar

Edhe për kundër faktit se Ligji nr. 03/L-019 për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, obligon të gjitha Institucionet që në çdo 50 të punësuar duhet të punësohet edhe një person me aftësi të kufizuar, ky obligim ligjor ende nuk është përmbushur ashtu sic e përcakton dispozita e nenit 13 të këtij ligji.

4. Zëvendësimi i kontratave të nëpunësve civilë

Pothuajse të gjitha institucionet që kanë të punësuar nëpunës civilë i kanë shëndërruar kontratat me akte të emërimit.

5. Komisionet disiplinore dhe procedurat disiplinore

Këshilli ka vërejtur se disa institucione nuk kanë themeluar komisionin disiplinor në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren për procedurën disiplinore në shërbimin civil. Lidhur me procedurat disiplinore në disa raste merren vendime pa i përfillur procedurat duke i anashkaluar edhe afatet ligjore. Këshilli ka vërejtur se anëtarët e Komisioneve Disiplinore nuk i kanë ndjekur trajnimet e detyrueshme për çështjet që ndërlidhen me procedurat disiplinore.

6. Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave

Kolegjet e Këshillit kanë vërejtur se disa organe të punësimit nuk i zbatojnë rekomandimet e Këshillit edhe pse që nga viti 2010 janë të obliguar që të formojnë Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në pajtim me nenin 81 dhe 82 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

7. Ndërprerja e marrëdhënies së punës

Këshilli ka vërejtur se ndërprerja e marrëdhënies së punës në disa Institucione është bërë në kundërshtim me procedurat dhe bazën ligjore. Disa Institucione u kanë ndërprerë marrëdhënien e punës nëpunësve civilë pa bazë ligjore në kundërshtim me dispozitat ligjore.

8. Përshkrimet e vendit të punës

Shumica e Institucioneve ende nuk kanë standardizuar përshkrimet e punës, gjegjësisht rregulloret mbi sistematizimin e vendeve të punës, duke kaluar procedimin e rishikimit të tyre dhe aprovimit përfundimisht nga menaxherët e personelit dhe zyrtari kryesor administrativ. Andaj, me qëllim që të përmbushet edhe ky kusht në pajtim me dispozitat e Rregullores mbi përshkrimin e vendeve të punës, Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka rekomanduar organet e punësimit që të bëjnë përshkrimin e vendeve të punës në afatin ligjor, duke rekomanduar veçanërisht që për titull të caktuar të punës të përcaktoj përgatitjen profesionale me një profesion.

9. Klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil

Shumica e Institucioneve ende nuk kanë përfunduar klasifikimin e vendeve të punës, sistematizimin e vendeve të punës dhe Rregulloren e brendshme në pajtim me Rregulloren nr. 05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës. Mbi këtë bazë, Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka rekomanduar organet e punësimit që të bëjnë përfundimin e klasifikimit të vendeve të punës, sistematizimin dhe Rregulloren e brendshme në afatin ligjor, mirëpo Këshilli ka konstatuar se moszbatimi i rregullores ka ngecur me neglizhencën e Institucioneve përgjegjëse për të bërë klasifikimin e vendeve të punës në mënyrë që të sigurohet një sistem i standardizuar i pagave.

10. Vlerësimi i kryerjes së punëve

Lidhur me këtë Këshilli, ka vërejtur se organet e punësimit relativisht kanë zbatuar rekomandimet që i ka dhënë Këshilli për vlerësim të kryerjes së punëve për vitin kalendarik. Vlerësimi ende vazhdon të bëhet në bazë të udhëzimit administrativ të mëhershëm për shkak të vështirësive në zbatim të rregullores për procedurat e vlerësimit të punës për nënpunësit civil.

11. Transferimi i nëpunësve civilë

Për procedurën e transferimit të nëpunësve civilë, Këshilli ka vërejtur se organet e punësimit transferimet jo gjithë herë i kanë bërë në përputhje me ligjin. Lidhur me këtë, Këshilli ka rekomanduar që të zbatohet neni 28 i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorja nr. 06/2010 për Transferimin e nëpunësve civilë.

12. Pushimet në shërbimin civil

Procedurat e pushimeve menaxhohen sipas procedurave të Rregullores nr. 06/2011 për pushimet e nëpunësve civilë, poashtu aplikohet edhe pushimi në bazë të përvojës së punës së deklaruar dhe të dëshmuar.

13. Orari i punës dhe vijueshmëria

Pothuajse në të gjitha Institucionet menaxhohet vijueshmëria në punë dhe respektimi i orarit të punës, në formën elektronike. Me përjashtim, disa organe të punësimit të cilat akoma nuk kanë një mekanizëm të ndërtuar mbi të dhënat e ardhje-vajtjes nga puna, për këtë arsye Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka obliguar organet e punësimit, që të plotësojnë këtë kusht.

14. Dosjet e personelit

Administrimi dhe mirëmbajtja e dosjeve të personelit janë në përmirësim të standardeve të kërkuara nga baza ligjore në fuqi. Në disa Institucione është vërejtur se dosjet e personelit nuk mbahen në vende të sigurta, nuk janë të kompletuara me të dhënat personale dhe nuk përditësohen në baza të rregullave për t'ju bashkangjitur ngritjen dhe zhvillimin profesional individual të nëpunësve civilë. Këshilli ka udhëzuar-rekomanduar menaxherët e personelit që të zbatohet neni 5 paragrafi 2 i Rregullores Nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin qendror të nëpunësve civil të Republikës së Kosovës, dhe që me rastin e rekrutimit të sigurojnë të dhënat për gjendjen civile dhe dosjen penale të kandidatëve të rekrutuar.

15. Trajnimet dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale

Këshilli, gjatë monitorimit të institucioneve ka vërejtur se planifikimi, programi dhe strategjia e trajnimeve të nëpunësve civilë nuk është në nivelin e nevojave për trajnim dhe zhvillimit profesional të personelit. Vërehet se organet e punësimit nuk kanë bërë analiza të mirëfillta për nevojat e trajnimit për stafin civil, gjë që shpesh herë trajnimet bëhen formale dhe në asnjë rast nuk është bërë vlerësimi

i cilësisë së trajnimeve, duke vlerësuar se sa kanë ndikuar trajnimet në ngritjen e kapaciteteve për vet nëpunësin civil dhe institucionin në tërësi.

C. FUNKSIONI I VËZHGIMIT

Funksioni i vëzhgimit për procedurat e zgjidhjes së nëpunësve civil të nivelit drejtues është i paraparë me nenin 10 paragrafi 1.2 dhe nenin 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në pajtim me dispozitën e përmendur, organet e punësimit në shërbimin civil, janë të obliguara që të njoftojnë Këshillin për kohën e mbajtjes së intervistës, plotësimin e vendeve të punës së nëpunësve civilë të nivelit drejtues. Në mënyrë që vëzhgimi të jetë konform procedurave ligjore, organi i punësimit duhet t'i paraqes Këshillit tërë dokumentacionin e nevojshëm lidhur me realizimin e konkursit për të cilin Këshilli është ftuar të marrë pjesë në vëzhgim.

Organet e punësimit, gjatë vitit 2013 publikimin e konkurseve e kanë bërë në pajtim me nenin 5 paragrafin 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë si dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit për Shërbimin Civil.

Këshilli gjatë vitit 2013 ka pranuar 29 ftesa për vizita vëzhguese të emërimit të nëpunësve civil në nivelin drejtues, mbi bazën e të cilave organet e punësimit kanë kërkuar që të vëzhgohen 38 pozita të nivelit drejtues.

Pas procedurës vëzhguese për pozitat e nivelit drejtues, nga ana e Këshillit gjatë vitit 2013 janë nxjerrë 38(tridhjetë e tetë) vendime përfundimtare, prej tyre:

- 34 (tridhjetë e katër) vendime përfundimtare të aprovuara si të rregullta;
- dy (2) vendime përfundimtare me të cilat ka rekomanduar Institucionin për rishpalljen e konkursit si dhe anulimin mbi përzgjedhjen e kandidatëve;
- një (1) Vendim për pezullim të procedurave sepse ka pasur ankesë në KPMSHCK;
- një (1) vendim me të cilin është anuluar konkursi, sepse Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil nuk ka qenë në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 të Rregullores 02/2010, për procedura të Rekrutimit në Shërbimin civil. (Shih tabelën në vijim):

Institucioni	Pozita e aprovuar nga Këshilli	Pozitat të cilat Këshilli nuk i ka aprovuar-ka rekomanduar -Rishpallje të konkursit.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtor i Departamentit të Prokurimit; • Drejtor i Drejtorisë për Monitorim, Vlerësim dhe Raport Mjedisor; • Drejtor i Institutit për Mbrojtjen e Natyrës. 	
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave. 	

Agjencioni i Statistikave të Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Administratës dhe Mbështetjes. 	
Qendra e Studenteve	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Administratës dhe Mbështetjes. 	
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	<ul style="list-style-type: none"> Kryesues i Departamentit të Financave. 	
Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Zyrës për të Drejtat e përafërta dhe të Drejtat e Autorit. 	
Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Departamentit i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore. 	
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Departamentit Juridik Administratë; Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut. 	
Ministria e Punëve të Jashtme	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme. 	
Ministria e Shëndetësisë	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave. 	
Agjencioni Kosovar i Pronës	<ul style="list-style-type: none"> Udhëheqës për Buxhet dhe Financa. 	
Ministria e Drejtësisë	<ul style="list-style-type: none"> Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës. 	
Institucioni i Avokatit të Popullit	<ul style="list-style-type: none"> Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit. 	
Ministria e Punëve të Brendshme	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Departamentit për Siguri Publike; Drejtor i Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar. 	
Ministria e Integritet Evropian	<ul style="list-style-type: none"> 1. Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme 	
Ministria e Drejtësisë-Shërbimi Korrektues i Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Prizren. 	
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor Ekzekutiv Financiar. 	
Institucioni i Avokatit të Popullit	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Departamentit të Hetimeve. 	
Ministria e Punëve të Brendshme	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa; Drejtor i Departamentit për Teknologji Informativë; Drejtor i Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve. 	
Ministria e Drejtësisë Agjencioni i Administrimit të Pasurisë	<ul style="list-style-type: none"> Drejtor i Departamentit për Administratë. 	

së Sekuestruar dhe Konfiskuar		
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëheqës i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve. • Udhëheqës i Departamentit të Industrisë 	
Instituti i Kosovës për Administratë	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtor i Administratës. 	
Ministria e Integriteteve Evropiane	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtor i Departamentit të së Drejtës së BE; • Drejtor i Departamentit të P.S.A. 	
Ministria e Punëve të Jashtme	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëheqës i Departamentit për Çështje Konsullore; • Udhëheqës i Departamentit për Evropë dhe BE; • Udhëheqës i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare. 	
Universiteti i Prishtinës		Rekrutimi për pozitën e Sekretarit të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyror, është anuluar sepse përbërja e Komisionit përzgjedhës të Shërbimit Civil, nuk ka qenë në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 të Rregullores 02/2010, për Procedura të Rekrutimit në Shërbimin civil.
Ministria e Infrastrukturës		1. Drejtor i Departamentit për Integritete Evropiane dhe Koordinim të Politikave. 2. Drejtor i Departamentit të Aviacionit Civil.
Ministria e Punëve të Brendshme		1. Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion. Pozita është anuluar, sepse ka pasur ankese në KPMSHCK.

Tabela nr. 18 Numri i rasteve për të cilat është bërë vëzhgimi nga Këshilli

VII. RAPORT PËR SHPENZIMIN E BUXHETI TË KËSHILLIT

Buxheti i aprovuar për Këshillin, sipas Ligjit 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, ka qenë në shumën prej 251.716.00 €, që i ndarë sipas kategorive ekonomike në mënyrë tabelore duket kështu:

Nr.	Kategoritë Ekonomike	Buxheti i Aprovuar 04/L-165 - fillestar	Buxheti i rishikuar Final - SIMFK	Ndryshimi
1	Paga dhe mëditje	185.851.00 €	185.851.00 €	00
2	Mallra dhe shërbime	61.365.00€	61.365.00€	00
3	Shpenzime kapitale	0 €		00
4	Shpenzimet komunale	4.500.00 €	4.500.00 €	00
	Totali	251.716.00	251.716.00	00

Tabela 19 - Alokimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike

Nga tabela e mësipërme shihet qartë se nuk ka dallim në mes të buxhetit fillestar të aprovuar dhe buxhetit final (rishikuar).

Mbikëqyrja e shpenzimeve

Gjatë vitit 2013, nga buxheti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli ka realizuar **98.39%** të buxhetit të paraparë. Buxheti i realizuar nëpër kategori ekonomike është si vijon:

- Paga dhe Mëditje është shpenzuar në masën **98.84%** .
- Mallra dhe Shërbime është shpenzuar **98.04%** nga buxheti i planifikuar për këtë kategori.
- Shpenzimet e komunale është shpenzuar në masën **84.93%** të buxhetit të planifikuar.

Nr.	Kodi buxhetor	Buxheti final	Të shpenzuara	Të pa-shpenzuara	Të shprehura në %
1	Paga dhe mëditje	185.851.00€	183.687.35€	2.163.65€	98.84%
2	Mallra dhe shërbime	61.365.00€	60.159.28€	1.205.72€	98.04%
3	Shpenzimet komunale	4.500.00€	3.821.71€	678.29€	84.93%
4	Shpenzime kapitale	00	00	00	00

Tabela nr. 20 Realizimi i Buxhetit sipas linjave buxhetore